



DPS	
Nr 23	Dos2
Dt. 15.01.2020	Vt.

MARRËVESHJE BASHKËPUNIMI

Ndërmjet

DREJTORIA E PERGJITHSHME E STANDARDIZIMIT (DPS)

dhe

UNIVERSITETIT POLIS

(Fakulteti Arkitekturë dhe Dizajn,
Departamenti Arkitekturë dhe Inxhinieri)

1. Palët e Marrëveshjes

Kjo marrëveshje nënshkruhet ndërmjet palëve të mëposhtme:

Drejtoria e Përgjithshme e Standardizimit (DPS), përfaqësuar nga Drejtori i Përgjithshëm z.
Riza Hasanaj,

Adresa: Rruga "Reshit Çollaku"
Godina ILDKP, Kati 6.

Dhe

Universiteti Polis, përfaqësuar nga Rektori, Z. Besnik Aliaj,

Adresa: **Rruga Bylis 12,**
Autostrada Tiranë – Durrës (Km 5)
Kashar, Tiranë, Shqipëri.

Palët në këtë marrëveshje janë organizma/ institucione autonome, të cilat bien dakord të punojnë në partneritet, për arritjen e objektivave të përbashketa, duke ruajtur identitetet e tyre të ndryshme, qëllimet dhe objektivat e tyre. Me vullnet të lirë e të plotë, palët e mësipërme ranë dakord për



hartimin dhe nënshkrimin e kësaj marrëveshje bashkëpunimi (këtu e në vijim do të quhet “Marrëveshja”) me kushtet e mëposhtme:

2. Objekti i Marrëveshjes

Objekti i kësaj marrëveshje është krijimi i marrëdhënieve të bashkëpunimit ndërmjet **DREJTORISË SË PËRGJITHSHME TË STANDARDIZIMIT (DPS)** dhe

Universitetit POLIS, për bashkëpunim në sektorin e ndërtimit dhe projektimit, në favor të rritjes së ndërgjegjësimit të studentëve të **Departamentit Arkitekturë dhe Inxhinieri** (Fakulteti Arkitekturë dhe Dizajn) mbi rolin dhe rëndësinë e standardeve të projektimit, Eurokodet.

3. Kohëzgjatja

Kjo Marrëveshje do të zbatohet për një periudhë 24 mujore, duke nisur që nga data e nënshkrimit. Kohëzgjatja mund të ndryshohet me marrëveshje me shkrim ndërmjet palëve. Marrëveshja rinovohet vetëm me marrëveshje me shkrim ndërmjet palëve.

4. Bashkëpunimi i përgjithshëm institucional

Të dyja palët bien dakort që realizimi i veprimtarive me interes të përbashkët të kryhet në varësi të burimeve, asetëve dhe potencialit të disponueshëm nga secili institucion.

Në nivel institucional, palët angazhohen që të mundësojnë:

- Shkëmbim të njohurive, stafit dhe infrastrukturës për bashkëpunim me interes reciprok.
- Përcaktimin e fushave të studimit me interes të ndërsjelltë në disiplinat e ndërtimit dhe projektimit.
- Informimin reciprok mbi të rejat dhe zhvillimet e fushës në secilin institucion dhe me gjerë që paraqesin interes për aktivitetin institucional të palëve.
- Shkëmbim të materialeve, botimeve dhe rezultateve të punës studimore dhe shkencore që realizohet në të dy institucionet.
- Nxitjen, mbështetjen dhe realizimin e veprimtarive të përbashkëta me interes reciprok.
- Mundësimin e projekteve, programeve dhe financimeve të përbashkëta me interes të ndërsjelltë.
- Shkëmbim të stafit dhe ekspertëve të dy institucioneve me qëllim zhvillimin e trajnimeve dhe kualifikimin e mëtejshëm të stafit nga të dyja palët.

5. Të drejtat dhe detyrimet e “DPS”

DPS merr përsipër të:

- Realizojë trajnime të studentëve ose stafit në çorkshope, seminare apo aktivitete që organizon DPS.
- Mundësojë Intershipe/ praktika profesionale për studentët e programeve të cilat organizohen nga Departamenti Arkitekturë dhe Inxhinieri.

- Realizojë leksione të hapura ose prezantime nga specialiste të DPS në universitet me qëllim informimin mbi literaturën e Eurokodeve.
- Mundësojë trajnime me studentët e Universiteti Polis për qëllime akademike.
- Realizojë aktivitete prezantuese, bashkëbisedime me studentë etj.
- Tregojë disponueshmëri për ide të gjeneruara nga studentët ose stafi për aktivitete të ndryshme.
- Njoftojë Departamentin e Arkitekturës dhe Inxhinierisë për aktivitetet dhe të rejtat në nivel evropian në fushën e projektimit dhe ndërtimit.
- Mbështesë çorkshop-et dhe praktikant profesionalë të realizuara në Universitet me konsulentë, materiale apo artikuj/shkrime.

6. Të drejtat dhe detyrimet e “Departamenti Arkitekturë dhe Inxhinieri“, (Universiteti Polis)

I cili merr përsipër:

- Të informojë DPS për aktivitetet akademike si: konferenca, leksione të hapura, forume, simpoziume etj., me interes për profilin e kompanisë.
- Të transmetojë tek studentët e vitit të fundit të studimeve ose Alumni, njoftime për standardet dhe procedurat për pjesëmarrje në procesin e hartimit dhe adoptimit të standardeve.
- Të zhvillojë aktivitete prezantuese, panaire, ditë të këshillimit të karrierës, bashkëbisedime me studentë etj., në mënyrë që të njihet aktiviteti dhe mundësitë e DPS-se.
- Të marrë feedback nga DPS në lidhje me sfidat e standardeve zyrtare në vendin tonë, dhe t'i ngrejë këto çështje diskutimi në nivel dekanati për përmirësimin e kurrikulave në këtë drejtim.
- Të informojë DPS për mundësitë e mëtejshme dhe shërbimet e ofruara nga Universiteti në lidhje me studimet e bazuara në standard dhe perfundimet e tyre.

7. Njoftimet dhe komunikimet ndërmjet palëve

8.

Palët angazhohen të mbajnë linja të hapura komunikimi në të gjitha nivelet dhe të shkëmbejnë çdo informacion të nevojshëm për punën e tyre.

Çdo njoftim dhe komunikim mes palëve për këtë Marrëveshje duhet të jetë në formë të shkruar. Komunikimet për efekt të kësaj marrëveshjeje do të kryhen drejtpërdrejt me Departamentin Arkitekturë dhe Inxhinieri, Fakulteti Arkitekturë dhe Dizajn të Universitetit POLIS.

Çdo njoftim dhe komunikim duhet të dërgohet personalisht, me postë ose me postë elektronike në adresat/kontaktet e mëposhtme:



Person kontakti për DPS:	Person kontakti për POLIS: DEPARTAMENTI ARKITEKTURE DHE INXHINIERI
Shqipëri, Tiranë, Rr.Reshit Çollaku, Godina ILDKP, Kati 6.	Shqipëri, Tiranë, Rr. "Bylis 12", Autostrada Tiranë-Durrës, Km 5, Kashar.
Drejtoresha për Çështjet Ligjore dhe Komunikimin: Kostanca Dedja	Shefe Departamenti: Doc. Dr. Merita Guri
Adresë e-mail:kostanca.dedja@dps.gov.al	merita_guri@universitetipolis.edu.al
Tel: +355 4 2226255 Cel: +355 692133110	Tel: +355 4 2407420 / +355 4 2407421 Cel: +355 682076469 Fax: +355 4 2407422

9. Ndryshime, Amendime, Revokime, Zgjidhje të mosmarrëveshjeve

Çdo pikë e marrëveshjes mund të ndryshohet, amendohet ose revokohet në çdo kohë, pas një konsultimi dhe mirëkuptimi reciprok ndërmjet dy institucioneve.

Çdo ndryshim i kësaj marrëveshjeje do të aprovohet me shkrim nga palët. Specifikimet dhe ndryshimet në këtë marrëveshje rregullohen me anë të anekseve të cilat bëhen pjesë e kësaj marrëveshjeje pasi firmosen nga të dyja palët.

Në raste të mosmarrëveshjeve, palët i zgjidhin ato me mirëkuptim nëpërmjet negociimit.

10. Hyrja në fuqi dhe përfundimi i Marrëveshjes

Kjo Marrëveshje hyn në fuqi nga data e nënshkrimit.

Kjo Marrëveshje hartohet në 2 (dy) kopje në gjuhën shqipe, nga një kopje për secilën palë, e cila nënshkruhet me vullnet të lirë nga të dyja palët, pasi është lexuar e kuptuar me qartësi.

Me mbarimin e afatit të kësaj marrëveshjeje, palët kanë të drejtë të rinovojnë këtë marrëveshje ose të formulojnë e nënshkruajnë marrëveshje të veçanta bashkëpunimi dhe partneriteti, për çdo veprimtari konkrete që përputhet me frymën e kësaj marrëveshjeje,

Nënshkruar në Tiranë, më 15/01/2020

Drejtoresha e Përgjithshme e Standardizimit

Drejtoresha e Përgjithshme

Riza Hasanaj



Universiteti POLIS

Rektor

Prof. Dr. Besnik Aliaj

